



VENDIM

Nr. 4 Datë 16.01.2012

**PËR
KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES “HEC KLOS” TE
SHOQËRISË “MALIDO ENERGJI” SH.P.K SI BURIM I
RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “ll”, 9 dhe 39 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9 pikat 1 dhe 2, gërma a, të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.01.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “MALIDO ENERGJI” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues për “HEC KLOS” si burim i rinovueshëm energjie,

Konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “MALIDO ENERGJI” sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrik nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 9, datë 21.02.2007, si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**
Është plotësuar tërësisht
- **Neni 7, pika 2, gërma “a”, “b”, “c”, “d”**
Është plotësuar tërësisht
- **Neni 7, pika 4, gërma “a”, “b”, “c”**
Është plotësuar tërësisht

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratoje kualifikimin e impiantit prodhues “HEC KLOS” te shoqërisë “Malido Energji” sh.p.k si burime te rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.